



UNMIK/REG/2005/37
22 korrik 2005

RREGULLORE NR. 2005/37
PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI ZEJTARINË I MIRATUAR NGA KUVENDI I
KOSOVËS

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në harmoni me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës të datës 21 tetor 2004 lidhur me Ligjin për zejtarinë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 27 shtator 2004,

Duke ditur se dispozitat e Ligjit nuk e cenojnë autoritetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas RKSKB 1244 (1999) apo pushtetin dhe kompetencat e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall Ligjin për zejtarinë i miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 2004/44), që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, i cili bëhet i plotfuqishëm në datën e nënshkrimit, me kusht që:

(a) Në titullin e kreut V dhe të nenit 52 fjalët „Dispozitat ndëshkimore” të zëvendësohen me „Masat administrative” dhe në nenin 52, 53 dhe 54 fjala „ndëshkim” të zëvendësohet me „masë administrative”.

(b) Neni 57 ndryshohet në: „Ky Ligj shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që nuk është në përputhje me të”;

(c) Fjala „Kosovë” kudo që paraqitet në tekstin e këtij Ligji zëvendësohet me fjalën “Kosovo” (në versionin anglisht).

Këto ndryshime do të paraqiten në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit.

Nënshkruar sot, më 22 qershor 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

